

VENDIM
Nr. 616, datë 31.8.2016

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 1080, DATË 23.12.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.11.2015, PËR ÇËSHTJEN “SHARRA DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË” (PËR ANKIMET NR. 25038/08, 64376/09, 64399/09, 347/10, 1376/10, 4036/10, 12889/10, 20240/10, 29442/10, 29617/10, 33154/11 DHE 2032/12)”

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të ligjit nr. 9235, datë 29.7.2004, “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nr. 10 i shtojcës 2 të vendimit nr. 1080, datë 23.12.2015, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“10. Kati, nr. 29617/10, Dëmi pasuror dhe dëmi jopasuror: 117 600 (njëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind) euro, kostot dhe shpenzimet: 850 (tetëqind e pesëdhjetë) euro.”.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama